



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d**, të Ligjit nr. 03/ L – 040, për Vetëqeverisje Lokale, nenit 15, paragrafi 5 i Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.3.2025, merr këtë:

**V E N D I M
PËR SUBVENCIONIMIN E TRANSPORTIT TË NXËNËSVE**

1. **Miratohet** Subvencionimi i transportit të nxënësve nga shtëpia në shkollë dhe anasjelltas.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, subvencionimi do të vlejë për nxënësit e nivelit parafillor dhe fillor, në rastet kur numri i nxënësve është nga një (1) deri katër (4) nxënës, të cilët udhëtojnë mbi 2 km në një drejtim, (në vendet ku nuk ka transport urban), atyre që jetojnë në vise rurale dhe zona urbane ku ka rrezik të lartë dhe nuk mund të organizohet transporti nga Drejtoria e Arsimit.
3. Sipas pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi, subvencionimi i transportit të nxënësve do të bëhet në vlerë prej 192.00 euro në muaj dhe vetëm për periudhat kohore sipas kalendarit vjetor të organizimit të procesit mësimor.
4. Subvencionimi i nxënësve do të bëhet në bazë të kërkesave nga institucionet arsimore dhe shqyrtimin sipas kritereve do ta bëjë një komision i themeluar nga Kryetari i kryeqytetit.
5. Obligohet Drejtoria e Arsimit që deri në seancën e radhës të bëjë një analizë për vendet ku është i nevojshëm subvencionimi i transportit të nxënësve.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kryetari i kryeqytetit, Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Financave.
7. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb – faqen e komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-346/03-45620/25, më 2.4.2025**

**KRYESUES I KUVENDIT
Fehmi Kupina**

